	<b>Blanchard dhe Thacker (1999)</b>	Modeli i Procesit të Trajnimit	I përshtatshëm kryesisht për organizata të mëdha ku trajnimi konsiderohet si një mjet zgjidhje problemesh. <i>Input</i> -i i çdo faze është <i>output</i> -i i çdo faze paraardhëse (identifikimi i nevojave për trajnim, konceptimi i programit, hartimi i programit, realizimi i trajnimit, vlerësimi i programit).
	<b>Bellis dhe Hattingh (2003)</b>	Procesi i Planifikimit të Zotësive	Proces që mund të përshtatet sipas situatës. Etapat e vendosura në mënyrë ciklike: hartimi i një plani për zhvillimin e zotësive, krijimi i një grupi përgjegjës, identifikimi i mënyrave të plotësimit të nevojave, përgatitja e planit, zbatimi, regjistrimi dhe raportimi i zhvillimit të zotësive, vlerësimi dhe rishikimi.

### Organizimi i Trajnimeve në institucionet publike

Në institucionet publike e shtetërore të Kosovës, duke ju falenderuar praktikave të vendeve të zhvilluara të cilat përmes projekteve të ndryshme të financuara nga organizata dhe shoqata të

<sup>19</sup>Dibra S. "Vlerësimi i aktiviteteve të trajnimit në organizatat e shërbimit në Shqipëri" punim doktrate, Tiranë 2013.



ndryshme, në shume institucione janë të organizuara mjaft mirë departamente që merren me trajnimin e të punësuarve në institucione. Trajnime këto si të të punësuarve të rinjë si dhe trajnime të vazhdueshme.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe metodologjitë e matjes së performancës pas trajnimeve si të punësuarve poashtu edhe institucionit.

Në vazhdim do të shtjellojmë shkurtimisht mënyren e organizimit si dhe zhvillimit të trajnimeve në disa institucione, ku tani është krijuar një pervojë në organizimin dhe zhvillimin e departamenteve të fuqishme të trajnimeve dhe rezultatet janë të matëshme.

### **Objektiva të ndryshme**

Është përpiluar një program një-vjeçar për inspektorët e rinj i cili përbëhet nga trajnimet në klasë dhe praktika e strukturuar në punë. Tri objektivat e para më shumë kanë të bëjnë me organizimin e mbrendshëm të një departamenti (divizioni) të trajnimeve ndërsa në vijim do të shtjellojme më në detaje trajnimin e trajnereve.

Programi i Trajnimit të Trajnerëve (PTT) është bërë ti ndihmon instruktorët në hartimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e trajnimeve. Hartimi dhe realizimi efektiv i trajnimit siguron që trajnimet të jenë të vlefshme sikurse për kohën e instruktorit ashtu edhe për kohën e pjesëmarrësve. Në këtë program, pjesëmarrësit mësojnë për Sistemin e Hartimit të Mësimeve (SHM) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për hartimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e trajnimit duke shfrytëzuar Modelin ADDIE.

Programi për trajnerë përbëhet nga tri kurse:

- Zhvillimi i Planprogramit (materialeve)
- Hartimi I Testit
- Aftësitë Prezantuese dhe Lehtësuese

### ***Zhvillimi i Planprogramit***

Së pari duhet përcaktuar sistemin e hartimit të mësimeve. Sistemi për Hartimin e Mësimeve (SHM) paraqet qasje sistematike në krijimin e programeve dhe materialeve trajnuese për arritjen e qëllimeve specifike mësimore. Në nivelin e lartë, procesi përbëhet nga identifikimi i njohurive të tanishme të individëve, përcaktimi i asaj çka duhet të dinë, dhe përpjekja për të mbushur

zbrazëtirën e identifikuar. SHM mbështetet në teoritë e bazuara në hulumtimin për mënyrën e mësimit të njerëzve, e cila ka rrënjët në psikologjinë e sjelljeve dhe të njohurive.

Që nga ditët e tyre të më hershme, planet mësimore kanë qenë të ndikuara nga pikëpamja se të mësuarit është një sistem i ndërlikuar që mund të lehtësohet nga teoria mësimore. Sipas kësaj pikëpamje, mësimi mund të zbërthehet në tri pjesë përbërëse: inputi, procesi, dhe outputi. *Inputi* përfshinë gjëra të tilla si njohuritë e mëparshme dhe përvoja të individit, nevojat e organizatës, dhe burimet në dispozicion.


*Procesi* përfshinë zhvillimin e kurseve dhe ofrimin e trajnimeve.

*Outputi* përfshinë rezultatet e mësimit dhe rezultatet organizative.

Qëllimi i SHM-së është që t'i ofrojë individëve atë për të cilën kanë nevojë, kur ata kanë nevojë, dhe në atë mënyrë që ata ta përvetësojnë pa vështirësi dhe ta përdorin atë. Për më shumë se tre dekada, modeli mbizotërues i SHM ka qenë modeli i sistemeve i cili përfshinë analizimin, hartimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin, i njohur si në gjuhën angleze si modeli ADDIE.

Paraqitja grafike e Modelit ADDIE: <sup>20</sup>

### 1.1.1 Modeli ADDIE



<sup>20</sup>Osinski, Diana : Doracak per trajnim te trajnereve (Projekti ESTAK, 2012)





Burimi: (Osinski, Diana : Doracak për trajnim të trajnereve- Projekti ESTAK, 2012)

ADDIE është proces në lëvizje, që nënkupton se çdo hap ka një rezultat i cili qonë tek hapi tjetër pasues:

- Analizimi i zbrazëtirës në mes të asaj që individët dinë tani, dhe asaj që duhet të dinë
- Hartimi/dizajnimi i intervenimeve mësimore për të plotësuar boshllëkun
- Zhvillimi i materialit mësimor sipas hartimit
- Zbatimi i programit trajnues sipas materialit të zhvilluar
- Vlerësimi i zbatimit të trajnimit.

Në vijim janë përshkruar secila nga pesë fazat e modelit ADDIE në mënyrë të detajuar.

### **Rezultatet e hulumtimit**

Sipas hulumtimit të bërë kemi me 33 ndërmarrje të zgjedhura në mënyrë rastësore. Përmes një pyetësi prej 10 pyetjeve dhe të dërguara në mënyrë elektronike, të cilës ju kanë përgjigjur në mënyrë të drejtë të gjithë respondentët e përcaktuar dhe pas analizimit të të dhënave kemi fituar këto rezultate. Pyetësi është i përbër nga 4 pyetje të përgjithshme ndërsa 6 pyetje tjera kanë të bëjnë me organizimet e ndryshme të cilat i kanë kompanitë në srtukturën e tyre.

#### **Pyetja 1**

Cila është veprimtaria kryesore e kompanisë tuaj?


Answered: 33 Skipped: 0

Në pyetjen e parë zgjedhur dhe 60.61 prodhuese dhe 12.11

#### **Pyetja 2**

Sa punëtor i ka kompania juaj ?

Answered: 33 Skipped: 0



përgjigjur të gjithë respondentët e 6 ose 9 prej tyre janë kompani


**Burimi: (Autori 2018)**

Në pyetjen e dytë sa punëtor i ka kompania kemi marr përgjigje nga të gjithë repodentët duke marrë përgjigje prej 51.52% ose 17 kompani të cilët kanë 1-9 punëtor, 18.18% pse 6 kompani kanë nga 49-250 punëtor, 15.15% ose 5 kompani kanë 9-49 punëtor dhe 15.15 % ose 5 kompani kanë mbi 250 punëtor.

**Pyetja 3**

A ka Korporata juaj menaxher për burime njerëzore (resurse humane)?

Answered: 33 Skipped: 0




Në pyetjen e tretë a ka korporata menaxher të burimeve njerëzore, kemi marrë 51.52% ose 17 prej tyre kanë dhënë përgjigje me po dmth kanë në organizimin e tyre menaxher të burimeve njerëzore kurse 48.48% ose 16 kompani nuk kanë menaxher të burimeve njerëzore.

**Pyetja 4**

Sa i kushton rëndësi Korporata/institucioni juaj trajnimeve të punëtorëve?

Answered: 33 Skipped: 0






Në pyetjen e katërt sa i kushton rëndësi kompania trajnimeve të punëtorëve janë 48.48% ose 16 kompania janë përgjigjur që i japin shumë rëndësi, 42.42% ose 14 kompani janë përgjigjur pak dhe 9.09% ose 3 kompani janë përgjigjur aspak nuk i kushton rëndësi trajnimeve të punëtorëve

### Pyetja 5

A ka Korporata/institucioni juaj departament të veçantë për trajnimeve?

Answered: 33 Skipped: 0




Burimi: (Autori 2018)

Në pyetjen a ka korporata/institucioni juaj departament të veçantë të trajnimeve 66.67% ose 22 kompani nuk kanë departament të tranimeve dhe 33.33% ose 11 kompani kanë departament të veqan në të cilin organizojnë dhe mbajnë trajnime për punëtorët e tyre.

### Pyetja 6 Trajnimet zakonisht i organizoni ?


Answered: 26 Skipped: 7



Në pyetjen ku i organizon trajnimet korporata/institucioni janë përgjigjur 26 respondent dhe 7 prej tyre nuk janë përgjigjur. 53.85% ose 14 kompani janë përgjigjur që trajnimet i mbajnë në vendin e punës, 26.92% ose 7 kompani kanë kombinuar në organizimin e trajnimeve në klasë dhe në vendin e punës kurse 19.23 ose 5 kompani kanë organizuar trajnimet në klasë në formë të seminarëve.

### Pyetja 7 Në çfarë periudhe kohore zakonisht organizohen trajnimet?

Answered: 26 Skipped: 7




Burimi: (Autori 2018)

Pyetja në çfarë periudhe kohore i organizon trajnimet i janë përgjigjur 26 repodent kurse 7 nuk janë përgjigjur. Prej tyre 30.77% ose 8 kompani i mbajnë trajnimet kur ka risi në legjislacion, gjithashtu edhe 30.77% ose 8 kompani i mbajnë trajnimet e rregullat, 19.23% ose 5 kompani i organizojnë trajnimet në fillim të themelimit të punës, kurse 19.23% ose 5 prej tyre kanë forma tjera të trjanimëve.

### Pyetja 8 A mendoni se trajnimet ndikojnë në rritjen e performancën e të punësuarve?

Answered: 28 Skipped: 5



Burimi: (Autori 2018)




Në pyetjen se a mendoni që trajnimet ndikojnë në rritjen e performancës janë përgjigjur 28 respondent dhe 100% janë përgjigjur me po ndikojnë në performancën e të punësuarve.

### Pyetja 9

A ka kriteret për matjen (vlerësimin) e efektivitetit pas trajnimeve të të punësuarve?

Answered: 33 Skipped: 0




Në pyetjen a ka kriter për matjen e efektivitetit pas trajnimeve të të punësuarve janë përgjigjur 33 respondent dhe 60.61% ose 20 prej tyre janë përgjigjur me PO dhe 39.39% ose 13 respondent kanë potencuar se nuk kanë nevojë sepse kuptohet se do të jenë efektive.

### Pyetja 10

A shfrytëzohen vlerësimet e performancës në sistematizimin e të punësuarve në vendet adekuata të punës dhe në avansimin e tyre në karrierë?

Answered: 33 Skipped: 0



Pyetja e 10 ka të bëjë me shfrytëzimin e performancës në sistemin e të punësuarve në vendet adekuata të punës dhe në avansimin e tyre në karrierë dhe prej 33 respondentëve që janë përgjigjur



54.55% ose 18 prej tyre kanë dhënë përgjigje me PO 6.06% ose 2 prej tyre janë përgjigjur me JO dhe me përgjigjen pjesërisht janë përgjigjur 39.39% ose 13 respondent.

### ***Përfundime dhe Rekomandime***

Nga analizimi i bërë për menaxhimin e burimeve njerëzore konkretisht për trajnimeve të organizuara në institucionet publike sipas Ligji Nr. 04/L -221 për Institutin e Kosovës. Kurse në korporatat kosovare përmes rezultateve të fituara nga anketat të cilat janë dërguara në mënyrë elektronike mund të themi se nga anketimi i 33 respondentëve konstatojmë se kemi pasur shumicën e ndërmarrjeve nga sektori i shërbimit dhe mbi gjysma e tyre janë korporata të vogla 1-9 punëtor ku më pak se gjysma ose 48.48% i japin rëndësi trajnimit të punëtorëve edhe pse të gjithë mendojnë se trajnimi i punëtorëve ndikon në rritjen e performancës së të punësuarit. Gjetja tjetër e hulumtimit ka nxjerr një rezultat jo të mirë pasi që vetëm 33.33% prej tyre kanë departament të burimeve njerëzore (kjo për faktin se janë mini korporata). Këto korporata trajnime të rregullta i mbajnë në vendin e punës 53.85% dhe në kombinim në klasë dhe vendin e punës 26.92% të cilat janë shumë praktike sipas mendimit tim personal dhe përvojës si trajner.

Institucionet vendore të vazhdojnë me trajnimet e punonjësve të duke rifreskuar dhe përdorur metoda bashkëkohore të trajnimeve që të kenë performancë sa më të mirë në mënyrë që edhe sistemimi në vendin e punës të jetë adekuat.

- Korporatat në Kosovë që të organizojnë dhe zhvillojnë trajnime të vazhdueshme me metodat bashkëkohore trajnuese, që të ndiqet trendi i zhvillimit tekniko –teknologjik dhe njohurive të reja, që kanë të bëjnë me vendin e punës së të punësuarve, për arsye se trajnimet janë të domosdoshme dhe thelbësore për rritjen e performancës së të punësuarve dhe performancës së korporatave që të jenë koherent me detyrat, qëllimet e ekzistencës dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të korporatave.
- Korporatat të krijojnë dhe zhvillojnë departamente të trajnimeve me trajner profesionist të cilët angazhohen në trajnimet e të punësuarve në institucione dhe korporata.
- Korporatat të bashkëpunojnë me institucionet si ato të arsimit të mesëm edhe atë universitar duke i paraqitur kërkesat e tyre për profile të ndyrshme të profesioneve, gjithashtu sygjeroj që të



---

njetën ta bëjnë edhe me drejtorit për punë sociale që edhe trajnimet e këtyre drejtorive të orientohen në plotësimin e nevojave të tregut.

- Burimet njerëzore të korporatave të vendosin në politikat e tyre të sistemimit të punonjësve bazuar në performancën e treguar dhe rezultatet e matëshme pas trajnimeve.



---

## Literatura

1. Manaxhimi i Burimeve Njerëzore, Dr. Shyqri LLACI, Dr. Zana KOLI, Tiranë
2. Paul Banfield- Rebecca Kay: Hyrje në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përkthyer: Jonida Bregu, Botimi UET Press 2011 Tiranë
3. Prof. Dr. Galantina Canco (Doraci):Menaxhimi i Burimeve Njerëzore Tiranë 2009
4. Menaxhimi i Resurseve Humane, Tekst universitar, Ymer Havolli, Riinvest, Prishtinë, 2003
5. Menaxhimi i resurseve humane, Enver KUTLLOVCI, Prishtinë, 2004
6. Dr.Ibrahim Kuka, Dr.Justina Shiroka-Pula, Mr.Besnik Krasniqi, Menaxhmenti dhe Vendosja, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë, 2006;
7. Prof. dr. Danilo Ž Marković, Prof.dr. Bogdan B Ilić, Prof.dr.L.Ristić, Menadžment Znajnja Top menadžment i liderstvo znanja – Beograd, 2012;
8. Dr. Filemon. A. Uriarte, Jr. Executive Director ASEAN Foundation; Introduction to Knowledge Management, Published (2008) by the ASEAN Foundation, Jakarta, Indonesia;
9. Prof. dr Petar Jovanović, Filip Jovanović, Knowledge management 2008;
10. Managing for the Long Term 2007, Ikujiro Nonaka;
11. Theodore Levitt,—The globalization of Markets in Kontron, A. M. Sunrise Sunset. Challenging Cataloging in Canada;
12. ACM: Ubiquity - By Thomas H. Davenport and Laërence Prusak. Working Knowledge: How Organizations Manage What They;
13. Thi Hai Hang Nguyen, Knowledge Management in Small and Medium Sized Enterprises in Developing Countries 2011;
14. Philip Kotler & Gary Armstrong, Parimet e Marketingut, Botimi i 13-të, përktheu Genti Beqiri, Tiranë, tetor 2013;
15. Lloyd A. Stanley. Guide to training curriculum development. 1987
16. Rob Cotterill. “Best practice guidance on training for small and medium sized enterprises”, 2004
17. Raymond A. Noe. ‘Employee training and development’, 5th edition
18. Metodologjia e punës shkencore kërkimore: Ali JAKUPI, dispensë, Prishtinë;





- 
19. Metodologjia e punës kërkimore shkencore për biznes, Nexhmi REXHA, Ligjërata të autorizuara, 2005 Prishtinë;
  20. Human Resource Management, Alan Price 2007 UK
  21. Human Resource Management, J. Bratton, J. Gold 2006 UK



---

## VLERËSIMI I NJOHURIVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLA FILLORE

**MA Besë Krasniqi, Jetmira Qovanaj**

**Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizrenit, Rruga e Shkronjave**

**nr.1, 20000 Prizren Kosovë**

**mailto:bese.krasniqi@gmail.com**

### Abstrakt

Vlerësimi i njohurive të nxënësve është procesi i mbledhjes dhe i grumbullimit të “të dhënave”, ose më konkretisht vlerësimi është një mënyrë se si mësuesit, në vazhdimësi i mbledhin të dhënat për mësimnxënien e nxënësve të tyre (Hanna & Detmmer, 2014).

Vlerësimi konsiderohet pjesë e të mësuarit dhe jo si moment që e ndërpret procesin mësimor. Vlerësimi mund të jetë i organizuar dhe i drejtuar nga institucionet arsimore të vlerësimit, por mund të jetë edhe i konceptuar e drejtuar nga mësuesi. Pra, vlerësimi është një veprim që kryhet me nxënësin dhe për nxënësin, dhe jo ndaj nxënësit (Green, 1999).

Ndryshimet në shoqëri bëjnë që edhe mësimdhënësit të përballen me detyra të reja në klasat e tyre. Deri vonë vlerësimi në klasë është konsideruar si një mekanizëm për sigurimin e një note të nxënies, i cili ka marrë për bazë një model të parashikuar: mësimdhënësit japin mësim, i testojnë njohuritë e nxënësve për përmbajtje të caktuara, gjykojnë për arritjet e tyre bazuar në ato testime, dhe më pas vazhdojnë me njësi të reja. Kjo formë e vlerësimit është vë në pikëpyetje sepse pritjet shoqërore për arsimin sot kanë ndryshuar, shkencat kognitive kanë dhënë rezultate të reja për natyrën e të nxënit, dhe roli tradicional i vlerësimit për motivimin e të nxënit tashmë është sfiduar. Me qëllim të përgatitjes së nxënësve për shkathhtësitë e shekullit 21 është e nevojshme që të përdoret edhe vlerësimi i shekullit 21.

Fjalët kyçe; vlerësimi, klasa, fëmijët, edukimi.



---

## 1. Hyrje

Proces i mbledhjes së të dhënave në mënyrë që të merren vendime për një individ apo një grup të caktuar.” (Salvianaand Yssldyke ,1998). Një varg metodash të përdorura për matjen e performancës dhe arritjes së nxënësve duke përfshirë, testimin, provimet, vlerësimet e punës praktike, vlerësimin me gojë, vlerësimet me bazë në klasë të udhëhequr nga mësimmhdhënsit.” ( Gipps,1994. Është proces i kërkimit dhe interpretimit të provave nga nxënësit dhe mësimmhdhënsit e tyre për të vendosur se ku janë nxënësit, ku duhet të arrijnë ata dhe si të arrijnë atje më së miri.” ( Basic Education Program,2013). Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të determinimit se në çfarë shkalle nxënësit i kanë zotëruar objektivat sipas udhëzimeve. Vlerësimi përmban përshkrimin sasior dhe cilësor, gjykon vlerat dhe meritat e nxënësve në përgjithësi dhe në veçanti, bazohet në matjen objektive, të saktë, të vlefshme dhe të besueshme të njohurive të nxënësve në shkollë. Mirëpo, se çfarë është në fakt vlerësimi si pjesë e procesit arsimor dhe proceseve edukative në tërësi, përgjigjia është kjo?

- a) Vlerësimi është gjykimi i mësuesit për cilësinë e nxënësve,
- b) Vlerësimi është një mënyrë sistematike e shikimit të çështjeve të rëndësishme,
- c) Vlerësimi është sigurim i informacionit për vendimmarrje,
- d) Vlerësimi shpesh lidhet me testimin dhe kufizohet në arritjet e nxënësve,
- e) Vlerësimi është një mjet konstruktiv për përmirësim dhe risi.

Vlerësimi dhe matja e njohurive të nxënësve shpesh përdoren në procesin edukativ në vend të njëra-tjetrës, mirëpo një veprim i tillë është i gabuar, sepse vlerësimi dhe matja nuk janë të njëjta. Matja është proces krahasimi të një sasie të njohur me një sasie të panjohur. Matja në arsim është proces i grumbullimit dhe i organizimit të rregullt të informacionit mësimor dhe edukativ. Mjetet kryesore të matjes janë: vrojtimi, testi me gojë, testi me shkrim, vetëvlerësimi, portfolio (dosja) etj.

Pra, nocionet vlerësim dhe matje nuk janë të njëjta. Përdorimi pasaktë i tyre mundë të qojë në përfundime të pasakta. Matja dhe vlerësimi janë pjesë përbërëse dhe jetësore të veprimtarisë së shkollave bashkëkohore. Kur masim diçka në arsim, atëherë përshkruajmë atë duke e vënë përballë diçkaje të krahasueshme. Ndërsa kur vlerësojmë diçka, atëherë ne gjykojmë në vlerat e saj. Pra, vlerësimi nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi, sasior dhe cilësor, bazuar në matje. Kjo do të thotë se vlerësimi si koncept është më i gjerë se sa



matja dhe në vete përfshinë edhe matjen. Pra, vlerësimi i nxënësve bëhet përmes këtyre llojeve të vlerësimit të cilat i njohim si: *vlerësimi diagnostifikues, vlerësimi formues, vlerësimi përmbledhës, i kontekstit, i brendshëm dhe vetëvlerësimi*, të cilët ndihmojnë shumë në krijimin e një përfytyrimi të mjaftueshëm për procesin e nxënies, së nxënësve apo individëve të caktuar që janë pjesë e një procesi edukativo-arsimor.

**Vlerësimi diagnostifikues** – përmes këtij vlerësimi identifikohen vështirësitë e të nxënit apo problemet që kanë të bëjnë me të nxënit. Po ashtu, përmes vlerësimit diagnostifikues identifikohen anët e dobëta dhe të forta të mësimdhënies, përcaktohen shkaqet e ndryshme të problemeve në mësimnxënie, në mënyrë që të merren masat për përmisimin dhe avansimit, për formulimin e planit për veprim në ndihmën e nxënësve.

**Vlerësimi formues** – përmes këtij vlerësimi synojmë të identifikojmë gabimet, të metat dhe vështirësitë në punën me nxënës, me qëllim që t'u japim ndihmë. Vlerësimi formues e mbikqyr ecurinë, procesin, përparimin e nxënësve, mësimdhënësve, siguron informata kthyesë për të sjellë përmirësime tek nxënësit. Kontrollon përparimin e nxënies së nxënësve gjatë procesit mësimor.

**Vlerësimi përmbledhës** – përcakton arritjet në përfundim të vitit mësimor, në përfundim të programit mësimor. Shërben për të marr vendime për nxënësit, mësimdhënësit, programet etj. Ka për qëllim notimin e nxënësve, gjithashtu siguron informata për të gjykuar përvetësimin e objektivave të lëndës dhe efektshmërinë e programit mësimor.

**Vlerësimi i kontekstit** – ka për qëllim të përcaktojë kontekstin e shkollës, të klasës, të përshkruaj kushtet dhe rrethanat e punës së shkollës, të identifikojë dhe të vlerësojë nevojat dhe mundësit në kontekstin e dhënë, ndikimin e tyre në arritjet e nxënësve dhe të shkollës.

**Vlerësimi i brendshëm** – kryhet nga brenda shkollës, mund të kryhet nga një mësimdhënës apo më shumë, apo edhe nga vetë drejtuesit e shkollës. Vlerësimi i brendshëm është më i përshtatshëm për përmbushjen e qëllimeve të vlerësimit formues. Ky vlerësim i mban në gatishmëri të përhershme mësimdhënësit e shkollës.



**Vlerësimi i jashtëm** – quhet i jashtëm sepse kryhet nga institucione të veçanta të ngarkuara për vlerësimin në shkollë, për vlerësimin e jashtëm në fund të shkallës së shkollimit, sic është testi i arritshmërisë, provimet e maturës. Vlerësimin e jashtëm mundëta kryej Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Drejtoria Komunale e Arsimit, etj, zakonisht vlerësimi i jashtëm përdoret për të përmushur qëllimet e vlerësimit përmblendhës ( vlerësimi sumativ).

**Vetëvlerësimi** – është proces gjatë të cilit institucionet, shkolla, mësimdhënësi, nxënësi mbledh informacion për veten e tyre dhe bëjnë gjykimin e vlerave të tyre. Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit kanë mundësi që në lidhje me qëllimet e caktuara të mësimin, të vlerësojnë veten, arritshmërinë e tyre. Vetëvlerësimi i bazuar në kritere të drejta, krijon bazë për të motivuar, përmirësuar dhe çmuar më tej të nxënësit nga ana e nxënësve.

Faktikisht shumë mësimdhënës kanë përvojë të madhe në procesin e edukimit, mirëpo jo të gjithë dinë të bëjnë një vlerësim të drejtë dhe sipas standardeve që sot janë të zbatueshme në shumë vende me nivel të lartë të arsimit në botë.

## **2. Qëllimet e vlerësimit**

Është shumë e rëndësishme që procesi i vlerësimit të ketë qëllimet e veta të cilat i japin kuptim vlerësimit, kështu që ne do të përshkruajmë disa lloje të qëllimeve të vlerësimit, të cilat janë:

- a) Ndihma ndaj nxënësit në procesin e të mësuarit,
- b) Identifikimi i pikave të forta dhe të dobta të nxënësve,
- c) Vlerësimi i efektivitetit të një strategjie të veçantë mësimore,
- d) Vlerësimi dhe përmirësimi i efektivitetit të mësimdhënies,
- e) Vlerësimi dhe përmirësimi efektiv i planprogramit mësimor,



Vlerësimi i nxënësve nuk ndihmon vetëm në krijimin e një pamje dhe përfytyrimi të vërtet të performancës së nxënësve, por ndihmon gjithashtu në rritjen e cilësisë së sistemit shkollor në përgjithësi. Prandaj, parashtrohet pyetja se çka në të vërtetë vlerësohet te nxënësit. E përgjigjia është kjo:

- a) Arritja e qëllimeve,
- b) Qëndrimet ndaj mësimëve shkollorë dhe
- c) Sjellja e nxënësve.

Arritja e qëllimeve nënkupton punën e nxënësit e cila vlerësohet në lidhje me qëllimet e Planit dhe Programit mësimor, apo zbatimit të kurrikulës shkollorë. Qëndrimi ndaj mësimëve shkollorë përbën bazën e një mësimi të rregullt. Vëzhgimet janë të përqëndruara gjithashtu mbi metodën e punës individuale apo metodës grupore.

Vlerësimi i sjelljes mbështetet në respektimin e rregullave të shkollës, e që këto rregulla i komunikohen si nxënësve, ashtu edhe prindërve. Në rast se një nxënës nuk i respekton rregullat, atëherë ai/ajo do të ndëshkohet me: detyra shtesë, mësim plotësues pas mbarimit të mësimi, përjashtim i përkohshëm apo përjashtim i përhershëm nga shkolla.

### **3. *Procesi i vlerësimit***

Çdo mësues duhet të dijë se sa e rëndësishme është puna e nxënësve në klasë dhe kjo për shumë arsye. Nëse një mësues është i saktë në procesin e vlerësimit të nxënësve të tij atëherë ai do të kuptoj se metodat e vlerësimit të tij po funksionojnë, si dhe do të kuptojë se për çfarë ndihme ka nevojë nxënësi. Pra, vlerësimi është mjeti më i rëndësishëm i procesit edukativo-mësimor prandaj të gjithë mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojën e përdorimit të mjeteve dhe metodave të shumta të vlerësimit. (Basic education program, 2013)



Kontrolli i njohurive dhe vlerësimi shkojnë bashkë, paralelisht. Nuk mund të ndodh që të bësh kontroll të njohurive e të mos vlerësosh, ashtu siç ndodh rrallë që të vlerësosh pa bërë kontroll të njohurive. Procesi i vlerësimit duhet të bazohet në vlerat e vërteta të mësimdhënies dhe në qëndrimet e mësimdhënësit dhe të nxënësit. Kjo nënkupton se patjetër duhet të kemi parasysh:

- 1) Vlerat e mësuesit dhe besimin e tij te nxënësit e tij,
- 2) Angazhimin e nxënësve për të vet-vlerësuar punën e tyre,
- 3) Bashkëveprimet e unifikuara, që ndihmojnë nxënësit të njohin hapat e ardhshëm dhe të dijnë se si t'i bëjnë ato hapa
- 4) Krijimin e bindjes, se çdo nxënës që punon ( mëson ) mund të përmirësohet,
- 5) T'i tregohet nxënësve me shembuj se qfarë pritet nga ai/ajo.

Pra, nga kjo kuptojmë se qëndrimet në procesin e vlerësimit, kanë shumë vlerë pasi që konsiderohet një proces shumë i rëndësishëm që përdoret për të mbledhur dhe grumbulluar të dhënat për njohjen e performancës së nxënësve. Ka shumë mënyra për të vlerësuar një nxënës në klasë, por ka edhe shumë faktorë që pasqyrojnë përparimin e nxënësit në klasë. Prandaj, vlerësimi i drejtë është në mjet nevojshëm vlerësimi, që duhet ta zotëroj çdo mësues, pa dallim. Në anën tjetër duhet pasur kujdes që vlerësimi i nxënësve dhe performanca e tyre të mos bëhet vetëm me disa metoda vlerësimi, sidomos jo vetëm me test, sepse ka nxënës që mund të jenë më të dobët në teste, për këtë arsye duhet vlerësuar performanca e përgjithshme me metoda të ndryshme të vlerësimit. ( Lemlech, 2003, fq 166)

#### **4. Standardet e vlerësimit**

Vlerësimi nuk ka përfundim, pra vlerësimi është ciklik. Vlerësimi shërben për t'i përdorur rezultatet për të përmirësuar të nxënësit e nxënësve në përgjithësi.

Sipas Dr. Daniel Stufflebeam, ( Dr.Daniel, profesor i njohur në fushën e vlerësimit, ligjërues në Universitetin e Ohajos, Michingenit) janë përcaktuar rreth 30 standarde të ndara në katër grupe të mëdha;

- a) Standarde të dobisë - vlerësimi i shërben nevojave praktike
- b) Standarde të mundësisë - vlerësimi realist dhe i matur
- c) Standarde të korrektësisë - karakteri i ligjshëm dhe teknik



---

d) Standard të saktësisë - shfaq dhe pasuron informacion të mjaftueshëm.

Mësimi dallon varësisht nga nevojat e nxënësve. Vlerësimi i mundëson nxënësit të përparoj, ndërsa mësuesit të përshtat më mirë mësimdhënien. Nga kjo rezulton se funksioni kryesor i vlerësimit është të ndihmojë për të kuptuar sa më mirë natyrën dhe cilësinë e çështjes që vlerësohet. Në veçanti, funksionet kryesore të vlerësimit janë këto:

- a) Funksioni formues; shërben për monitorim, planifikim, përmirësim, angazhim të mëtejshëm, përfundim, zhvillim dhe formim.
- b) Funksioni përmbledhës; shërben për njohje të përgjegjësisë, për bilancimin e njohurive dhe aftësive të arritura gjat vitit shkollor, për llogaridhënie, për përzgjedhje, për certifikim, për akreditim, etj.
- c) Funksioni proaktiv, i shërben procesit të vendimmarrjes.
- d) Funksioni retroaktiv, i shërben procesit të llogaridhënies;
- e) Funksioni psikologjik e social, shërben për të motivuar sjellje të dëshiruara, për të zhvilluar marrëdhënie dhe mbështetje publike, etj.

## **5. Si duhet të bëhet vlerësimi i nxënësve?**

Vlerësimi i punës mendore dhe intelektuale të një individi është një proces mjaft i vështirë, e sidomos kur kemi të bëjmë me nxënës ku me anë të vlerësimit mund t'i motivojmë nxënësit, por edhe t'i dekurajojmë ata. Vlerësimi duhet të jetë i drejtë nga të gjithë mësimdhënësit, me tendencë të stimulimit përmes vlerësimit të punës dhe angazhime të tyre në shkollë, duhet të jetë objektiv nga të gjithë mësimdhënësit.

Vlerësimi nëpër shkolla tona bëhet me kujdes dhe seriozitet të madh, ku përfshihen këto aspekte të veprimit:

- a) *Punën e rregullt sistematike,*
- b) *Mbajtjen e testeve të rregullta sipas planit zyrtarë të sjellur nga DKA( Drejtoria Komunale e Arsimit)*
- c) *Vlerësimin e nxënësve ndaj punës shkollore dhe sjelljeve të tyre në shkollë,*





---

Një varg punësh të thjeshta të përqëndruara kryesisht mbi njohuritë e nxënësve dhe teknikat e punë së tyre, mundë të përbëjnë bazën e një vlerësimi ose të një note me të cilën mund të vlerësohet një nxënës. (Broshurë për mësues, Confederation Suisse)

Punimet e parapara për vlerësimin e nxënësve duhet të bëhen në fillim të vitit shkollor. Mësimdhënësi i njofton nxënësit me qëllimet dhe kriteret të cilat përdoren për vlerësim. Kështu nxënësi përgatitet të mësoj dhe t'i përshtatet metodave të mësimdhënësit të tij. Sot praktikohet që çdo mësimdhënësi t'i informoj gjerësisht nxënësit e tij për rregullat e vlerësimit, standardet e vlerësimit, kohën e vlerësimit si dhe kuotat e njohurive që duhet të tregohen për një notë të caktuar. Ky udhëzim duhet të jetë fuqiptotë dhe të mos pësojë ndryshim kohë pas kohe, në mënyrë që vlerësimi të jetë serioz i drejtë dhe i paanshëm.

### **6. 3.6 Nevoja për një vlerësim ndryshe**

Procesi mësimor i nënshtrohet në mënyrë të vazhdueshme formave të ndryshme të vlerësimit të mësimdhënies. Deri më tani vlerësimi është bërë sipas standardeve të tjera, të cilat shpesh nuk kanë dhënë rezultate të mira. Kohët e fundit janë bërë përpjekje për ndryshimin dhe avancimin e metodave të reja të vlerësimit të nxënësve.

Qëllimi kryesor i një vlerësimi ndryshe të nxënësve është që:

- ✚ Të identifkohen dobësitë e sistemit ekzistues të vlerësimit të nxënësve dhe
- ✚ Të shqyrtohen pasojat nga vlerësimi joadekuat i nxënësve.

Ne dijmë se qëllimi kryesor dhe fundamental i shkollës është që përmes mekanizmave të vetë t'i mësojë nxënësit, duke ju dhënë njohuri të sakta, edukim adekuat dhe t'i përgatisë nxënësit për jetë. Vlerësimi është proces i ndërlikuar, por nga ta pritet që të mos mungoj përpjekja për një vlerësim të drejtë të nxënësve. Është vërtetuar se vlerësimi përmirëson mësimdhënien dhe të mësuarit në tërësi. Prandaj themi se:

- 1) Vlerësimi siguron informatë kthyese efektive,
- 2) Vlerësimi kyç i nxënësit në mënyrë aktive në procesin mësimor,
- 3) E përshtat mësimdhënien duke i marrë parasysh rezultatet nga vlerësimi,



- 4) Zmadhon motivimin dhe vetrespektimin e nxënësve, si faktorë kyç në mësim,
- 5) Merr parasysh nevojën për inkuadrimin e nxënësve në vlerësim, për të kuptuar se si mund të përmisohet mësimnxënia e tyre. (Gary D, Borich , Metodologjia e mësimdhënies, 2003)

## **7. Vlerësim formativ**

*“Kur gjellëbërësi shijon supen që ka zier vetë, ky është vlerësim formativ”*

Thënie e shkruar nga Paul Black

Vlerësimi për nxënie apo vlerësimi formativ është proces i vëzhgimit sistematik që siguron një kuptim më të mirë të asaj se çfarë kanë mësuar nxënësit dhe si do të angazhohen ata thellësisht në procesin e të nxënësve. Ai i drejton nxënësit në procesin e të nxënësve dhe u mundëson atyre të fitojnë aftësi të nevojshme që do të jenë të dobishme për arritjen e rezultateve më të mira. Vlerësimi për nxënie mbikqyr përparimin gjatë procesit të të nxënësve, siguron informata kthyesë për ta lehtësuar të nxënësve dhe për ta përmirësuar mësimdhënien.

Vlerësimi për nxënie ka këto qëllime:

- Të sigurojë një informatë kthyesë me qëllim të përmirësimit të të nxënësve;
- T’i motivojë nxënësit për nxënie të mëtejshme;
- Të identifikojë anët e forta dhe ato të dobëta të nxënësve ;
- T’i orientojë nxënësit në profesionet e ardhshme;
- Ti orientojë nxënësit për zhvillimin individual;
- Të klasifikojë, përzgjedh dhe ndihmojë në proceset vendimarrëse,
- Të sigurojë informacione të nevojshme për marrjen e vendimeve për zhvillimin dhe formimin e sistemit arsimor;
- Të sigurojë të dhëna për kërkime në shkencat e edukimit....

Çdo vlerësim i cili qëllim kryesor ka t’i shërbejë nxitjes së nxënësve për të nxënë , është vlerësim joformal, i ngulitur në të gjitha aspektet e mësimnxënies dhe mësimdhënies, dhe i realizuar nga mësimdhënësi të ndryshëm si pjesë e stilit të mësimdhënies së tyre individuale. ( Black, Harrison, Lee, Bazic Education Program, 2003). Çdo gjë që nxënësit bëjnë, si p.sh, biseda në grupe,



përgjigje në pyetje, parashtrimi i pyetjeve, puna në grupe, dorëzimi i detyrave të shtëpisë, madje edhe mënyra se si është ulur i qetë apo konfuz – është burim potencial i informatës se çfarë ka kuptuar apo nuk ka kuptuar nxënësi. Mësimdhënësi i cili në mënyrë të vetëdijshme përdor vlerësimin për të përkrahur mësimnxënien, e pranon këtë informatë, e analizon dhe merr vendime të cilat i adresohen kuptimeve dhe keqkuptimeve që janë zbuluar. (Thompson, Wiliam, 2008)

Vlerësimi është formativ kur mësimdhënësit mbledhin të dhëna dhe i interpretojnë provat e të menduarit të nxënësve apo kryerjen e detyrës, dhe pastaj t'i përdorin ato prova për të marrë vendime të mëtejme për mësimdhënien dhe të nxënit.

### ***8. Roli i mësimdhënësve, nxënësve, drejtorëve dhe prindërve në vlerësimin për Nxënie***

Vlerësimi për nxënie ndodh në të gjithë procesin e të nxënit. Ai është ndërveprues, që bashkë me mësimdhënësit mundëson:

- Përafrimin e mësimdhënies me rezultatet e synuara, identifikimin e nevojave të veqanta të nxënësve apo të grupeve të caktuara për të nxënë,
- Zgjedhjen dhe përshtatjen e metodave, materialeve dhe burimeve, krijimin e strategjive të ndryshme të mësimdhënies dhe mundësive për t'i ndihmuar nxënësit të ecin përpara në të nxënit e tyre,
- Sigurimin e informative kthyesë dhe orientimin e nxënësve.

Mësimdhënësit e përdorin vlerësimin për nxënie për ta rritur motivimin e nxënësve dhe angazhimin e tyre për të nxënë, u mundëson mësimdhënësve të marrin informata të qarta se si ndodh të nxënit tek secili nxënës në mënyrë individuale. Mësimdhënësit duhet ta planifikojnë vlerësimin për të nxënit si pjesë përbërëse të mësimdhënies dhe të nxënit.

Kur mësimdhënësit angazhohen në të nxënit e fokusuar në vlerësim, ata ndryshojnë kulturën në klasë, përqëndrohen në suksesin e nxënësit. Ata e bëjnë të dukshëm atë që nxënësi beson se është e vërtetë, dhe i shfrytëzojnë të dhënat për t'i ndihmuar nxënësit që të ecin përpara në mënyrë efektive dhe të suksesshme.

### **Cikli i vlerësimit për nxënie e sjellë nxënësin afër qëllimeve të të nxënit**



Nxënësit janë në qendër të vlerësimit për nxënie, sepse ata luajnë rolin kryesor në vlerësim. Çdo veprim që merr mësimdhënësi gjatë **ciklit** të vlerësimit bëhet në ndërveprim me nxënësit. Mësimdhënësit vlerësojnë përparimin e nxënësve drejt përmbushjes së qëllimeve, kurse nxënësit duke i ditur ato qëllime, ofrojnë të dhëna në lidhje me të kuptuarit e tyre. Sa më shumë që nxënësit e vlerësojnë veten e tyre, aq më shumë do të jenë në gjendje të vendosin për hapat e tyre të ardhshëm për të nxënë.

Nga ana tjetër drejtorët luajnë rol vendimtar në kërkimin e mënyrave më të mira për strukturimin e mësimin, sigurimin dhe shpërndarjen e burimeve, motivimin e mësimdhënësve për ta ngritur cilësinë në punë e tyre të përditshme dhe bashkëpunimin me prindër dhe me palët tjera të interesit në të gjitha nivelet.

Vlerësimi për nxënie u mundëson:

- **Nxënësve**, të marrin pjesë në mënyrë aktive për të kuptuar se si dhe çfarë duhet bërë për të ecur përpara;
- **Mësimdhënësve**, të gjykojnë mirë për arritjet e nxënësve dhe t'i shfrytëzojnë ato gjykime për të bërë plane shtesë;
- **Shkollave/Drejtorëve**, të vendosin një sistem të vlerësimit të strukturuar dhe sistematik që është i menaxhueshëm dhe i dobishëm;
- **Prindërve dhe kujdestarëve**, të informohen se si po përparojnë fëmijët e tyre çfarë duhet të bëjnë, si mund t'i mbështesin ata dhe mësimdhënësit e tyre.

Vlerësimi formues është treguar mjaft produktiv në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, sepse ju mundëson mësuesëve që krahas shpjegimit dhe mësimdhënies, të bëjnë edhe vlerësimin e përgjithshëm të njohurive që marrin nxënësit gjatë këtij procesi. Vlerësimi për nxënie, është efektiv sidomos në klasë, sepse ju mundëson nxënësve të vlerësohen përmes procesit mësimor, përsëritjeve, aktiviteteve, angazhimeve, detyrave, përgjigjive të çastit, komenteve, performancës së përgjithshme, etj.



### ***Literatura***

1. Murati, Prof. Dr. Xheladin “Didaktika” ( Metodologjia e mësimdhënies), Tetovë, 2002
2. Nuredini, DR,sc. Vaxhid. “Teoria e mësimi” ( Me nxënës, student në qendër), Prishtinë, 2008
3. Murchan, Dr. Damian, Gerry, Dr. Shiel “Basic Education Program”, Vlerësimi Formativ, 2013
4. Hanna and Detmmer, “Term Assessment for junior Hight Schools”, 2014
5. Green , Kneese, Carolyn, “Balancing Education”, 1999
6. Lemlech, Johanna Kasin, “Teaching in Elementary and Secondary Classrooms: Building a Learning Community” Dec 11, 2003
7. Confederation Suisse, “ Broshurë për mësues”
8. Gary, Dr. Borich, “ Metodologjia e mësimdhënies”, 2003